



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 8, lidhur me nenin 21, të Ligjit për financat e pushtetit lokal, Nr. 03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008”, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-108 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2016”, e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 30.05.2025, miraton këtë;

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim pjesëtarët e Policisë së Kosovës, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre, që janë me vendbanim në territorin e Komunës së Suharekës, **LIROHEN** nga pagesat në shërbimet mjekësore parësore që ofrohen nga organet shëndetësore në tërë territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Qendra kryesore e mjekësisë familjare, Qendrat e mjekësisë familjare dhe Ambulantët.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-31322
Më datë 30.05.2025



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI